

FJALA HAPËSE NË KOMITETIN KOMBËTAR TË SISTEMIT TË PAGESAVE

Të nderuar Kolegë, të ftuar dhe pjesëmarrës!

Në drejtim të këtij sesioni ndihem i obliguar të ndaj me ju rëndësinë dhe prioritetin që industria bankare i ka kushtuar zhvillimit të shërbimit të pagesave, si pjesë e rëndësishme dhe hapi i parë i madh në kuadër të digjitalizimit.

Ne si AAB kemi organizuar një forum në muajin qershor të këtij viti, i cili rezultoi shumë i suksesshëm në evidentimin e problematikave dhe dhënies së disa zgjidhjeve për digjitalizimin. Me siguri shumë prej jush keni qenë të pranishëm në këtë Forumin . Pa dashur të përsëris çështjet që u diskutuan, më lejoni t'ju bëj me dije se propozimet dhe kërkesat e paraqitura nga referuesit në atë forum u përmbledhën në një Concept Note dërguar Kryeministrit, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Guvernatorit. Gjej rastin të falënderoj Bankën e Shqipërisë për konsiderimin e këtij materiali, përgjigjen e kthyer dhe reagimin profesional.

Sot, para se ne të njihemi me dy prezantime shumë interesante, siç është ai për rregullimin e open-banking dhe autentifikimin e thelluar të klientit, dhe projekti instant payment, gjej me vend të sjell një pamje të shpejtë të situatës së digjitalizimit të sistemit të pagesave nga këndvështrimi i AAB.

1. Shkurtimisht disa shifra. Duke shtrirë rezultatin e gushtit të këtij viti në bazë vjetore, rezulton që për vitin 2022 numri i transaksioneve online të rritet 17% ndaj vitit 2021 dhe 46% me vitin 2020. Kurse volumi i transaksioneve online të rritet me 16.% ndaj vitit 2021 dhe 34% ndaj vitit 2020.

Numri i transaksioneve me kartë për vitin 2022 parashikojmë të rritet me 13% ndaj vitit 2021 dhe 35% ndaj vitit 2020. Kurse volumi i transaksioneve me kartë të rritet me 15 % ndaj vitit 2021 dhe 40 % ndaj vitit 2020.

Numri i kartave në qershor arriti në 1,270,324 me një rritje vjetore prej 2% - kjo në sajë të rritjes së kartave të debitit. Numri ATM është rritur me 10% dhe ai i POS-eve me 14%.

Pra, rritja e numrit dhe volumit të transaksioneve me kartë dhe online është shoqëruar me zgjerim të infrastrukturës dhe numrit të përdoruesve.

2. Është ngritur Grupi i Punës me përfaqësues nga 4 institucione për digjitalizimin e pagesave të shërbimeve publike të ofruara nga e-Albania. Jemi pranë unifikimit të rrjedhës së veprimeve dhe parametrave teknikë për të filluar secila bankë zbatimin. Synojmë që në janar të ofrojmë këtë shërbim për qytetarët.

Një fushatë edukuese për këtë qëllim do të ishte e domosdoshme. Prandaj AAB është duke punuar së bashku me VISA për realizimin e saj.

3. E-banking ofrohet nga të gjitha bankat.
4. Është punuar me DPPPP për ndryshimet e duhura ligjore për rregullimin e hapjes së llogarisë në distancë. Drafti është gati dhe presim të procedohet për miratim.
5. Në informacionin tonë si Shoqatë, disa banka janë në një stad të avancuar me përgatitjet për *open banking*. Kemi afat edhe një vit për të qenë gati me tregun.
6. Jemi drejt përfundimit të miratimit të *alternative channel* – mbledhja e sotme është e rëndësishme për të konfirmuar projektin *instant payment*, i cili më pas do shoqëruar me një plan veprimi me afate konkrete.

Në mënyrë që të përfshijmë edhe Qeverinë në mbështetje të kërkesave të paraqitura në Concept Note, do të na duhet që të kemi përfunduar projektin *instant payment*. Atëherë do të na duhet njohja e detyrueshme e *alternative channel* nga çdo njësi biznesi, kufiri i pagesave në *cash* dhe luftimi i informalitetit.

Duke pasur në vëmendjen tonë risqet që sjell përdorimi i kanaleve digjitale në shërbimet e pagesave, do t'i kushtojmë një tjetër fushatë ndërgjegjësuese dhe edukuese gjatë vitit të ardhshëm.

Sfida jonë e radhës mbetet *open banking*, në tërësinë e kompleksitetit teknik dhe operacional të të kuptuarit dhe zbatuarit. Investime të konsiderueshme nevojiten, angazhim për të kapur afatet dhe përgjegjshmëri në sigurinë dhe cilësinë e shërbimit.

Ndodhemi para zhvillimeve të rëndësishme dhe epokale. Këto janë ndryshime që bëjnë histori. Kryerja e shërbimit të pagesave edhe nga institucione financiare jo-banka, mos-shkuarja fizikisht në degë

banke dhe përmbushja e kërkesave për banking nga kompjuteri apo smartphone janë sfida të përqafuara nga industria bankare. Ato nuk janë teorike, por realitet i prekshëm, i cili në një afat të shkurtër do të jetë më tërësor.

Nuk po zgjatëm më tej, për t'i lënë kohën prezantimeve sipas agjendës së këtij sesiioni.